Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Majlinda Bedrolli	**19.05.2023**	**29.05.2023**	**2023/0284**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 18.05.2023, OE "Adem Pireva B.I."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0284, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Riparimi i pjeseve per automjetet e PK-se" me nr. të prokurimit: "214-23-3155-2-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS.Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, kontratë publike kornizë lloji i kontratës shërbim vlera e parashikuar e kontratës: 70,000.00 €. Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 56 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 62 i LPP-së
Neni 38 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik
Neni 43 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik.

Të nderuar ne me dt.05.05.2023 përmes platformës elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me vendimin e AK-së, ku është anuluar aktiviteti i prokurimit, ndërsa neve na ka eliminuar me arsyetimin si në vijim:

"Të kjo ofertë-Adem Pireva B.I Prishtinë, konkretisht te "Deklarata nën betim janë kërkuar të dhënat e OE: Emri dhe mbiemri, pozita, nënshkrimi, data, vula, që të plotësohen dhe të nënshkruhet nga përfaqësuesi i operatorit ekonomik, në rastin konkret nuk është plotësuar dhe nënshkruar nga Adem Pireva-pronar i kompanisë, ndërsa është plotësuar nga personi që nuk është kompetent dhe i autorizuar, konkretisht nga Muhamet Pireva, që ky personi në fjalë nuk ka autorizim në ofertë për të përfaqësuar në ofertë për të përfaqësuar këtë kompani".

Në lidhje me arsyen e eliminimit, ju sqarojmë se Drejtor i operatorit ekonomik "Adem Pireva B.I" me emër tregtar është NSHT ,,Pireva", ndërsa deklaratën nën betim e ka nënshkruar i autorizuari Muhamet Pireva.
Ju sqarojmë se gjatë ofertimit ka ndodh një lëshim teknik, me ç 'rast nuk është bashkangjitur autorizimi i Muhamet Pirevës edhe pse i njëjti ka autorizim gjeneral, madje ka autorizim për përfaqësim në të gjitha institucionet, Bankat, duke përfshirë edhe tërheqje të mjeteve financiare, nënshkrim të kontratave të punës, të qirasë, të nënshkruaj zgjidhje të kontratave etj. Pra z.Muhamet Pireva ka autorizime edhe më të gjëra se sa nënshkrimi i deklaratave në betim.
Autorizimi për Muhamet Pireva është i noterizuar dhe atë me **dt.11.03.2020** me nr.**LRP.Nr. rendor.3494/2020** tek noterja Sevdije S. Krasniqi.

Pra autorizimit i figuron data para datës së hapjes së ofertave dhe si i tillë duhet të merret parasysh dhe të konsiderohemi OE i përgjegjshëm. Edhe përkundër faktit që ne nuk e kemi bashkangjitur autorizimin, AK-ja është dashur që konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së të kërkon sqarime shtesë dhe pas sqarimeve ne do të e kishim ofruar autorizimin e tillë.
Autoriteti kontraktues është dashur ti shfrytëzoj dispozitat e nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së në mënyrë të arsyeshme dhe profesionale, e jo të veproj në drejtim të anulimit dhe të dështimit të këtij tenderi pa ndonjë arsye faktike dhe ligjore, duke pasur parasysh se ne jemi ofertues i vetëm në këtë aktivitet të prokurimit.

Neni 59.2 e parasheh qartë që *"**Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve**"*.

Në këtë rast AK-ja është dashur të veproj sipas nenit 59.2 të LPP-së dhe të na kërkoj sqarime shtesë.

Në bazë të dështmisë së ofruar tani nga ne, pra të autorizimit noterial me datë para hapjes së ofertave po dështmohet në mënyrë objektive se ky autorizim ka ekzistuar para datës së hapjes së ofertave dhe kjo dështmi është në përputhje të plotë me nenin 72.3 të LPP-së ku shkruan qartë : "***Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive***.

Dëshmi

Bashkangjitur keni autorizimin e noterizuar para hapjes së ofertave të z. Muhamet Pireva

Edhe neni 38 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik e parasheh decidivisht mundësinë për të kërkuar sqarime shtesë. Këto mundësi parashihen si në vijim:

Neni 38.1 Për të lehtësuar ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, AK mund të kërkoj nga secili tenderues individualisht për sqarim të tenderit të tij/saj. KRPP ka aprovuar një *formular standard* B47 për sqarime për të përdorur nga AK *"Kërkesë për sqarim të tenderit"*. Kërkesa për sqarim dhe përgjigja duhet të bëhet përmes platformës elektronike.

Neni 38.3 Megjithatë, lejohet që një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkoj dhe të marrë informacione apo dokumente, të cilat mungojnë në aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, në mënyre objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para datës se publikimit të Njoftimit për kontrate.

Gjithashtu kërkesa që duhet të prezantohet autorizimi për personin që e nënshkruan deklaratën nën betim, nuk ka qenë kërkesë e dosjes së tenderit, prandaj mund të konsiderojmë se autoriteti kontraktues, ka vepruar edhe në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së, sepse jemi eliminuar për një kërkesë e cila nuk ka qenë kërkesë e FDT-së, kurse dispozita e lartcekur e parasheh qartë *"56.3 Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit."*

Kërkojmë nga ju që të detyroni AK, që të merr parasysh autorizimin e noterizuar dhe të rishqyrtoj edhe njëherë vendimin e saj për anulim të këtij aktiviteti të prokurimit.

Ne me dt.12.05.2023 kemi pranuar vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, ku AK-ja e ka cekur se e njëjta është e pa bazuar, mirëpo nuk ka dhënë ndonjë fakt apo arsye konkrete për një refuzim të tillë

Autoriteti kontraktues nuk i ka marr parasysh fare faktet dhe dëshmitë tona të cilat i kemi prezantuar në kërkesën për rishqyrtim, mirëpo vetëm ka dhënë arsyetime se kinse i ka respektuar dispozitat ligjore për të cilat ne kemi pretenduar që nuk janë respektuar nga ana e AK-së.
AK-ja ka dhënë arsyetime të pa baza mirëpo vetëm e ka cekur se janë respektuar dispozitat e LPP-së, mirëpo nuk ka dhënë asnjë arsyetim në lidhje me pretendimin tonë sa i përket nenit 38 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik. Ashtu siç edhe e kemi cekur edhe më lartë neni i lartcekur e parasheh qartë si në vijim:
Neni 38.1 Për të lehtësuar ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, AK mund të kërkoj nga secili tenderues individualisht për sqarim të tenderit të tij/saj. KRPP ka aprovuar një *formular standard* B47 për sqarime për të përdorur nga AK *"Kërkesë për sqarim të tenderit"*. Kërkesa për sqarim dhe përgjigja duhet të bëhet përmes platformës elektronike.

Neni 38.3 Megjithatë, lejohet që një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkoj dhe të marrë informacione apo dokumente, të cilat mungojnë në aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, në mënyre objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para datës se publikimit të Njoftimit për kontrate.

5/4

Pra AK-ja pasi që nuk ka mundur të arsyetoj të kundërtën e pretendimit tonë në lidhje me mos kërkimit të sqarimeve, e njëjta nuk e shqyrton fare këtë pretendim duke e treguar qartë diskriminimin që po i bën kompanisë tonë si OE i përgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit.
Po ashtu e njëjta nuk e ka marr parasysh fare edhe autorizimin të cilin ne e kemi prezantuar për Muhamet Pireva i cili është i noterizuar dhe atë me dt.11.03.2020 me nr.LRP.Nr. rendor.3494/2020 tek noterja Sevdije S. Krasniqi, pra i njëjti është i noterizuar para datës së hapjes së ofertave dhe si i tillë është dashur të merret parasysh.

AK-ja me këto veprime nuk i ka respektuar dispozitat ligjore të LPP-së dhe Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik dhe njëkohësisht po e tregon qartë diskriminimin që po na bën neve si kompani, duke mos i marr parasysh faktet dhe dëshmitë konkrete, në të cilat janë të mbështetura pretendimet tona ankimore.

Duke u bazuar në të gjitha faktet e lartcekura, kuptohet qartë se vendimi i AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim është i pa bazuar dhe i paqëndrueshëm.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë, rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, **e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.**

Anulimi i aktivitetit të prokurimit është bërë plotësisht në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së.
Anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit është bërë edhe në kundërshtim me nenin 43.5 dhe 43.7 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik, pasi që nuk janë plotësuar asnjëra nga kushtet e përcaktuara në këto dispozita.

Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, pasi që paragrafi 1 i këtij neni e parasheh qartë që *"Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente*, ndërsa autoriteti kontraktues nuk e ka zbatuar këtë dispozitë sepse neve na ka diskriminuar, edhe pse jemi OE i përgjegjshëm dhe i përmbushim të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit.

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në faktet që u përmenden me lartë, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që të shqyrtoj ankesën tonë dhe të nxjerr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE **"Adem Pireva" B.I me emër tregtar NSHT Pireva.**
ANULOHET, njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) dhe lënda të kthehet në
RIVLERSIM dhe gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

6/4

KRITERET PËR VLERËSIM

III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë: **a)Operatori ekonomik duhet te përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092,do të dorëzohen në formë të Aneksit 2**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **a) Një deklarata e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2 – origjinal.**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratë Publike
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova i Javne Uprave
Ministry of Internal Affairs and Public Administration

Policia e Kosovës / Policija Kosova / Kosovo Police

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë /
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES[1]
Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik

Titulli i kontratës: Riparimi i pjesëve për automjetet e PK-së –ritender

Nr. i Prokurimit:	**214-23-3115-2-2-1**
Nr i brendshëm	**214/23/017/221**

Nr.	**Emri dhe adresa Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës**	**Vlera totale e ofertave**[2]
1.	Adem Pireva B.I., Nr 35 A, Lidhja e Prizrenit, 10000, Prishtinë, Kosovë	1,901.50 €

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:

Policia e Kosovës rekomandon anulimin e aktivitetin e prokurimit.

Data: 05/05/2023

Emri dhe mbiemri i ZPP: Artan Fejza

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Adem Pireva B.I.**

Autoriteti Kontraktues – Policia e Kosovës, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedure të hapur, kontratë publike kornizë, lloji i kontratës shërbim. Vlera e parashikuar 70,000.00 €.Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, përkatësisht kundër arsyetimit të eliminimit të operatorit ekonomik ankues.

Në bazë të formularit B58 Njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues-Policia e Kosovës të dt:05.05.2023, AK anulon aktivitetin e prokurimit. Ndërsa përmes letrës standarde për tenderuesin e eliminuar OE "Adem Pireva B.I" të datës 04.05.2023, ka potencuar: Tenderi juaj është administrativisht i papërgjegjshëm: me arsyetimin:

"Te kjo ofertë-Adem Pireva B.I Prishtinë, konkretisht te "Deklarata nen Betim" janë kërkuar te dhënat e OE: Emri dhe Mbiemri, pozita nënshkrimi, data, vula që të plotësohen dhe të nënshkruhen nga përfaqësuesi i operatorit ekonomik ne rastin konkret nuk është plotësuar dhe nënshkruar nga Adem Pireva-pronari i kompanisë, ndërsa është plotësuar nga personi qe nuk është kompetent dhe i autorizuar konkretisht nga Muhamet Pireva që ky person në fjalë nuk ka autorizim në ofertë për të përfaqësuar këtë kompani. "

Kundër arsyetimit të eliminimit, OE ankues parashtron kërkesë për rishqyrtim ku AK-Policia e Kosovës, përmes vendimit te datës 12.05.2023, refuzon kërkesën për rishqyrtim si të pa bazuar.

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, njoftimit të AK–së për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe pretendimeve të OE ankues, se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 56, 59, 60, dhe 62 të LPP-së, si dhe nenin 38 dhe 43 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik, OE ankues potencon se gjatë ofertimit ka ndodhë një lëshim teknik me ç'rast nuk është bashkangjitur autorizimi i personit të autorizuar. OE ankues potencon se autorizimi mban datën para hapjes së ofertave dhe si i tillë duhet të merret parasysh dhe të konsiderohemi OE i përgjegjshëm. **Ekspertja shqyrtuese** sqaron se AK tek Kërkesat e përshtatshmërisë ka kërkuar:

Kërkesat e përshtatshmërisë:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
a)Operatori ekonomik duhet te përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092,do të dorëzohen në formë të Aneksit 2	**a) Një deklarata e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2 – origjinal.**

Sqarojmë se në ofertën e parashtruesit të ankesës, rezulton qe i njëjti në ofertë ka të bashkangjitur deklaratën nën betim të nënshkruar nga personi Muhamet Pireva, ndërsa pronar i biznesit është Adem Pireva. Megjithatë, në kërkesën për rishqyrtim dhe në ankesën e parashtruar në OSHP nga OE ankues është bashkangjitur kopja e aktit noterial përmes të cilit autorizohet z. Muhamet Pireva që të ta përfaqëson në të gjitha organet Komunale Kadastrale, Administrative, ATK, Gjykatave, para Noterit, Doganave, Organeve Policore dhe Ministrive përkatës, si dhe para të gjithave organeve tjera Shtetërore Kompetente, etj. Akti noterial përmes të cilit është autorizuar z. Muhamet Pireva nga Adem Pireva B.I. mban numrin **LRP. Nr. rendor: 3494/2020. Ekspertja shqyrtuese** sqaron se në bazë të kësaj kopje të aktit noterial, e cila është bashkangjitur nga operatori ekonomik ankues Adem Pireva B.I **në kërkesën për rishqyrtim dhe ne ankesën e parashtruar në OSHP** me numër **LRP. Nr. rendor: 3494/2020**, rezulton se ky autorizim është para datës së njoftimit për kontratë dhe para afatit për dorëzimin e tenderëve, përkatësisht me datë 11.03.2020.

Ekspertja shqyrtuese sqaron se edhe vetë OE ankues e pohon se në ankesë nuk ka bashkëngjit autorizimin e aktit noterial për përfaqësim të personit i cili ka dorëzuar ofertën. Lidhur me këtë, **ekspertja shqyrtuese sqaron** se operatorët ekonomik të cilët shprehin interes për një aktivitet të prokurimit janë përgjegjës për ngarkimin e të gjitha dokumenteve të kërkuara në sistemin e prokurimit para afatit të fundit për dorëzimin e tenderëve për të dëshmuar se plotësojnë kërkesat dhe kriteret e përcaktuar në dosjen e tenderit. Këtë konstatim, **ekspertja shqyrtuese** e bazon në nenin 32, par. 32.4 të Rregullores Nr. 001/2022 Për Prokurimin Publik. Megjithatë, AK ka mund që të kërkoj sqarime shtesë nga OE ankues pasi

që parashtruesi i ankesës se bashku me kërkesën për ri shqyrtim e ka prezantuar kopjen e autorizimit të aktit noterial, ku është dhënë autorizimi për përfaqësim të personit i cili ka dorëzuar ofertën, dhe njëheri autorizim mban datën para datës së njoftimit për kontratë dhe para afatit për dorëzimin e tenderëve, megjithatë, autoriteti kontraktues dëshminë e tille nuk e ka trajtuar si të mirëqene. **Ekspertja shqyrtuese** konsideron se AK gjatë ri vlerësimit mundet të kërkoj informata shtesë të verifikoj aktin noterial se a është i autorizuar z.Muhamet Pireva, të përfaqëson në emër të biznesit NSHT "Pireva" por duke u siguruar që ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet, ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive konform nenit 72.3 të LPP-së.

Në mbështetje të asaj që u përshkrua si më lartë, ekspertja shqyrtuese konsideron se vlerësimi i ofertave nuk është bëre në harmoni me nenin 59 të LPP-së, gjithashtu anulimi i aktivitetit të prokurimit është bëre në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së.

Provë: Bashkangjitur me raport gjeni kopje e Autorizimit nga noterit LRP. Nr. rendor: 3494/2020, te OE ankues "Adem Pireva B.I" ,Deklaratën Nën Betim, si dhe Pamje të shkëputura nga platforma e-prokurimit ku dëshmohet se OE ankues ka dorëzuar me kërkesë për rishqyrtim kopjen e aktit noterial.

Numri i prokurimit:214-23-3155-2-2-1, **214/23/017/221**-Titulli: Riparimi i pjesëve për automjete të PK-së - ritender

Aneksi 2. DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: [*Pireva NSHT*] deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Nenin 65, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në Nenin 65 të LPP-së, respektivisht paragrafin 6 të Informacionit për Tenderuesit dhe vërtetoj se i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë për pjesëmarrje ne këtë procedure te prokurimit.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklarata që përmban informata përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	PIREVA NSHT
Adresa e plotë:	Rr. Lidhja e Prizrenit nr 35 A, Prishitne
I përfaqësuar nga:	
Emri	Muhamet Pireva
Pozita	Menaxher
Nënshkrimi	
Data	26.04.2023
Vula	N.T.SH. PIREVA FUSHË KOSOVË AUTO SERVIS


Dosja e tenderit
Kthehu te lista e kërkesave
Kërkesë për rishqyrtim
1. Dokumentat
2. Identifikimi i OE
3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit
4. Dispozitat e shkelura nga AK
5. Faktet dhe argumentet
5.1. Faktet dhe argumentet
6. Dëmet materiale
7. Vendimi i AK-së
8. Dokumenti i vendimit të AK-së
1. Dokumentat
Dokumentat
Dërguar nga : Adem Pireva B.I.
Kërkesë për rishqyrtim
Kërkesë për rishqyrtim - Kërkesë për rishqyrtim
08.05.2023 12:52
Kodi i dokumentit:
Hape:
Shqip
Dokumenti Shtojca
08.05.2023 12:53 Kërkesa per Rishqyrtim-Adem Pireva 06.05.2023.pdf
Hape:
Shqip
Dokumenti Shtojca
08.05.2023 12:54 Autorizimi i noteruar.pdf
Hape:
Shqip
Vendimi i AK në Kërkesën për rishqyrtim
Vendim mbi refuzimin e kërkesës së OE 12.05.2023.pdf
12.05.2023 13:36
Hape:
Shkarko të gjithë dokumentacionin
Shqip
Vazhdo

Republika e Kosovës
NOTER
SEVDIJE S. KRASNIQI
Prishtinë

LRP. Nr. rendor: 3494/2020

AKT NOTERIAL

Me datë(2020-03-11), para meje Sevdije S. Krasniqi, notere në Prishtinë, Rr. "UÇK", nr. 1, është paraqitur:----------

Adem Pireva B.I., me emër tregtar: **NSHT. "Pireva "**, me numër unik identifikues: 810443987, me seli në 35 A, Lidhja e Prizrenit, Prishtinë, me pronar: **Adem (Hasan) Pireva**, i/e lindur me [redacted] në Lupç i Poshtëm, me zotësi të veprimit, shtetas/e i/e Republikës së Kosovës, i/e identifikuar përmes Letërnjoftimit, me numër identifikues: [redacted] me vlefshmëri deri me datën [redacted], në rolin: Autorizuesi. ----------

Pala ka kërkuar nga noterja që në prani të tij/saj të redaktohet ky:----------

----------**A U T O R I Z I M**----------

Autorizuesi/ja deklaron:----------

AUTORIZOJ: Muhamet Pireva, i/e lindur në Lupç i Poshtëm, me [redacted], bartës/e i/e Letërnjoftimit, me numër identifikues: [redacted], **që pa praninë time:**----------

Lidhur me Biznesin tim, **" Adem Pireva B.I.",** të më përfaqësoj para të gjitha Organeve Komunale, Kadastrale, Administrative, Administratës Tatimore të Kosovës, Gjykatave, para Noterit, Doganave, Organeve Policore, dhe Ministrive përkatëse dhe para të gjitha Organeve tjera Shtetërore Kompetente.----

---

Mund të më përfaqësojë në të gjitha Bankat e Republikës së Kosovës, (lidhur me deponim dhe tërheqje e mjeteve financiare të biznesit të lartcekur, të nënshkruaj Kontrata e Kredive, mbitërheqje dhe të gjitha produkteve tjera nga bankat) të menaxhojë dhe të operojë me llogarit duke mos u kufizuar me të drejtën për çdo lloj tërheqje, transfere, deponime, transaksione të të hollave, të nënshkruajë marrëveshje për E-Banking dhe resetim i E-Banking.----------

Të nënshkruajë Kontrata për shitjen dhe blerjen e Automjeteve, të më përfaqësoj pranë Qendrës së Regjistrimit të Automjeteve, të bëjë regjistrimin e tyre, ç'lajmërimin, mund t'i vozisin brenda dhe jashtë Kosovës.----------

Të nënshkruaj Kontrata Punë, Kontrata të Qirasë, të caktoj dhe pranoj kushtet, në rast nevoje të nënshkruaj Zgjidhje Kontratave, Aneks Kontrata, Autorizime, revokim autorizimi, vërtetim origjinali, vërtetim nënshkrimi, të bëjë pagesa dhe aktet tjera të cilat kërkohen për mbarëvajtjen e biznesin tonë. -----

---

Çdo veprim ligjorë që ndërmerr i autorizuari im, lidhur me të dhënat lartcekura, i konsiderojë si t'i kisha marr unë vet.----------

---

Përmbyllja:----------

Ky akt u përpilua në bazë të Ligjit nr. 06/l-010 Për Noterinë.---- ----------

Konstatoj se tek pala nuk ka pas konfuzion, pasiguri të vullnetit .----------

Konfirmoj se ky akt i është lexuar palës, dhe ka deklaruar se ky Autorizim është shprehje besnike e vullnetit të tij/saj.----------

Vërtetoj se origjinali i këtij akti i epet palës ndërsa kopja mbetet tek noterja, nga i njëjti nuk mund të nxirret asnjë kopje autentike.----------

Konstatoj se ky akt është hartuar pandërprere në Zyrën e noteres dhe në prani të palës, i/e cili/a e nënshkroi aktin bashkë me noteren.----------

Shërbimet noteriale në shumë prej 23.72 €, TVSH e llogaritur në çmim është paguar konform Nenit 21.8 dhe Neni 41.5, të Udhëzimit Administrativë Nr. 02/2012, për Tarifat e Punës Noteriale.----------

Prishtinë, datë (2020-03-11) .------- ----------

Dhënësi/ja i/e Autorizimit: Adem Pireva B.I. **Noter:**

Me pronar: **Adem Pireva** Sevdije S. Krasniqi

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **POLICIA E KOSOVËS**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **Adem Pireva B.I.**

REPUBLIKA E KOSOVËS
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
PRISHTINË/A
REPUBLIKA KOSOVA

Majlinda Bedrolli